

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Maqedonia e Veriut rishikon rregullat për “pasaportat e arta”, por shqetësimet e BE-së mbeten
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/14/maqedonia-e-veriut-rishikon-rregullat-per-pasaportat-e-arta-por-shqetesimet-e-be-se-mbeten/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 09:46:48 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 09:24:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0afd7005d049a13b1a7d1b1ba40b001d1614cc7c1db73eb2aa8f224b3a00be11
TEKSTI	11601ad33d982ec45639e218c3141f01d429bcb12be4dbc18a86645beb4138d3
PAMJA	f7b98e7b67714e4fcf263e32c9367a77800637486d1f65ffdf0f826005a232891

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b485d6a065148e6f6e8e353d49bce43f52abff88144fc0dbc035b2d7742717f4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e4ff47e3158deeff08239dfd88de708dba9085a414711b421c21bd29dcd303ca
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b485d6a065148e6f6e8e353d49bce43f52abff88144fc0dbc035b2d7742717f4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kryefaqja Rajoni

Maqedonia e Veriut rishikon rregullat për “pasaportat e arta”, por shqetësimet e BE-së mbeten

Maqedonia e Veriut planifikon të heqë prapun e investimit për marrjen e shtetësisë, pas kritikave të BE-së lidhur me rreziqet e mundshme të sigurisë për zonën Shengen, por individëve me “interes të veçantë” mund t'u jepen ende pasaporta.

nga Frosina Dimeska — 15 seconds më parë në Rajoni Koha e leximit: 5 min lexim

AA 0



Foto: BIRN,

Bashkimi Evropian ka kritikuar ndryshimet e propozuara në Ligjin për Shtetësinë të Maqedonisë së Veriut, duke thënë se ato nuk shkojnë aq larg sa duhet për të hequr skemën e “pasaportave të arta”, për të cilën kritikët thonë se abuzohet gjerësisht.

Në qershor, qeveria në Shkup propozoi ndryshime që, sipas saj, do të shtrëngonin rregullat për shtetësinë dhe do t'u përgjigjeshin shqetësimeve të BE-së lidhur me skemën e saj të “pasaportave të arta”.

Propozimi heq prapun prej 400,000 eurosh investim në këmbim të shtetësisë, si edhe kërkesën që personi të punësojë 10 njerëz.

Megjithatë, autoritetet do të mund t'u japin ende shtetësinë individëve që konsiderohen me interes të veçantë për Maqedoninë e Veriut, qoftë për arsye ekonomike, kulturore, sportive apo të tjera, siç bëjnë edhe shumë vende të tjera në mbarë botën, përfshirë vende anëtare të BE-së.

Kritikët thonë se, ndërsa ndryshimet mund ta heqin skemën e “pasaportave të arta” në letër, në praktikë ato lënë të paprekur një procedurë për “interes të veçantë”, e cila vitet e fundit ka çuar në disa vendime shumë të debatueshme për dhënien e shtetësisë.

Edhe vetë BE-ja tha se ndryshimet e propozuara nuk janë të mjaftueshme.

“Heqja e pragut prej 400,000 eurosh, ndërkohë që ruhet mundësia e dhënies së shtetësisë për arsye të interesit të veçantë ekonomik, nuk do t'i përgjigjej rekomandimit të Komisionit”, tha Delegacioni i BE-së në një deklaratë për BIRN.

“Përkundrazi, heqja e pragut mund ta zgjerojë skemën dhe ta bëjë dhënien e shtetësisë edhe më të varur nga diskrecioni i autoriteteve.”

Por Ministria e Brendshme, e cila hartoi ndryshimet, tha për BIRN se ato janë përgatitur pikërisht për t'u përgjigjur shqetësimeve të BE-së. Ministria këmbënguli se problemi kryesor i BE-së nuk është praktika e dhënies së shtetësisë mbi bazën e “interesit të veçantë”, por vetëm pragu i shumë që duhet investuar, i cili tani po ndryshohet.

Anëtare e ardhshme e BE-së?



Maqedonia e Veriut rishikon rregullat për “pasaportat e arta”, por shqetësimet e BE-së mbeten

11:24 | 14/09/2026

Të rinjtë shfrytëzohen si vrasës me pagesë në “luftërat” e drogës në Ballkan

11:10 | 14/09/2026

I dërguari i Trump, me mision lobimi në Tiranë për rizgjedhjen e kreut të FIFA

06:54 | 14/09/2026

“Bed & Breakfast”: Në Durrës, bizneset po heqin dorë nga numërimi i turistëve

07:47 | 13/09/2026

‘PISA 2025’: Pasqyra e deformuar e suksesit të qeverisë me arsimin

08:31 | 12/09/2026

Qeveria jep 90 mijë m2 me 1 euro për investimin strategjik në Gjirin e Lalëzit

16:53 | 11/09/2026



Selia e qeverisë së Maqedonisë së Veriut në Shkup. Foto: BIRN.

Vitet e fundit, shtetet anëtare të BE-së si Malta, Qiproja dhe [Bullgaria](#) kanë hequr skemat e "pasaportave të arta", të cilat lejonin dhënien e shtetësisë individëve në këmbim të një investimi financiar.

Eurodeputetët e kanë cilësuar këtë praktikë "të papranueshme nga pikëpamja etike, ligjore dhe ekonomike" dhe kanë paralajmëruar për rreziqet e sigurisë për zonën Shengen të Evropës. Organizata kundër korrupsionit Transparency International thotë se skema të tilla "nuk i shërbejnë investimeve apo migrimit të mirëfilltë, por interesave korruptive".

Skema ka sjellë raste si ai i [Shawn Andre Scott](#), një investitor në industrinë e kazinove, i cili në vitin 2019 investoi 405,000 euro – vetëm pak mbi pragun e përcaktuar – për hapjen e një salloni flokësh në Shkup dhe punësoi 13 persona.

Si rrjedhojë, Scott, shtetas amerikan dhe banor i ishullit Saipan në Paqësor, mori shtetësinë maqedonase në vitin 2021. Rreth 18 muaj më vonë, ai tërhoqi 80,000 euro nga investimi i tij dhe salloni i flokëve ndërroi pronar.

Megjithatë, Scott e mbajti pasaportën e re. Nëse Maqedonia e Veriut një ditë anëtarësohet në BE, ai do të bëhet automatikisht shtetas i Bashkimit Evropian.

Një raport i publikuar nga Komisioni Evropian në dhjetor 2025 mbi përputhshmërinë e vendeve me kërkesat e BE-së për udhëtimin pa viza përsëriti se skemat e dhënies së shtetësisë në këmbim të investimit në vendet që gëzojnë udhëtim pa viza paraqesin rreziqe të qenësishme për sigurinë, pasi mund t'u mundësojnë shtetasve që përndryshe do të kishin nevojë për vizë të anashkalojnë kontrollet standarde të sigurisë për hyrjen në zonën Shengen.

Sa i përket posaçërisht Maqedonisë së Veriut, Komisioni vuri në dukje se numri i shtetësive të dhëna në bazë të kësaj dispozite ka mbetur shumë i kufizuar, por tha se rekomandimi i tij për Maqedoninë e Veriut mbetet i qartë: vendi duhet të "heqë skemën dhe të shfuqizojë bazën e saj ligjore". Shkupi duhet gjithashtu të japë informacion mbi aplikimet e paraqitura tashmë në bazë të dispozitës për interes të veçantë ekonomik dhe të sigurojë kontrolle të rrepta të së kaluarës për të gjitha aplikimet e tilla, shtoi Komisioni.

Maqedonia e Veriut e prezantoi skemën aktuale të dhënies së shtetësisë në këmbim të investimit me Ligjin për Shtetësinë të vitit 2012. Megjithatë, sipas Komisionit Evropian, njerëzit kishin marrë shtetësi mbi bazën e interesave të tyre ekonomike në vend edhe përpara kësaj. Nga viti 2005 – viti kur Maqedonia e Veriut u bë vend kandidat për anëtarësim në BE – deri në vitin 2023, gjithsej 121 persona e morën shtetësinë në këtë mënyrë, ndërsa 40 aplikantë u refuzuan, sipas Komisionit Evropian.

Vendime të diskutueshme për shtetësinë

Ndërsa ndryshimet e propozuara heqin nivelin e kërkuar të investimit, "interesi i veçantë" mbetet një rrugë për marrjen e shtetësisë.

Në Maqedoninë e Veriut, kushdo që aplikon në këtë mënyrë i nënshtrohet verifikimeve nga ministria përkatëse, qoftë Ministria e Ekonomisë ose e Financave, Ministria e Kulturës apo ajo e Sportit.

Sipas ndryshimeve të propozuara, këto verifikime do të vazhdojnë.

"Vlerësimi nëse një aplikant i caktuar përfaqëson një interes të veçantë për shtetin do të kryhet individualisht nga autoritetet përkatëse shtetërore, të cilave do t'u jepet një rol specifik dhe i drejtpërdrejtë, në varësi të institucionit përgjegjës për fushën në fjalë (për shembull, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Sportit etj.)", tha ministria për BIRN.

Me këto ndryshime, tha ajo, "sigurohen përzgjedhje më e rreptë, përgjegjshmëri institucionale dhe vlerësim individual i çdo aplikimi".

Megjithatë, në të kaluarën, në thelb i njëjti sistem verifikimesh ka çuar në disa vendime të diskutueshme për dhënien e shtetësisë.

ne vitin 2015, për shtetësi, qeveria e atëherëshme e qendrës së ujitje e kryeministrit Nikola Gruevski u dha shtetësinë Seemanto Roy dhe Sushanto Roy, djemve të biznesmenit indian Subrata Roy, pronarit të Sahara Group, i cili kishte premtuar të investonte në sektorët e turizmit dhe bujqësisë në Maqedoninë e Veriut.

Por ndërsa Subrata Roy po pritej në Maqedoninë e Veriut si një mesia ekonomik, financat e tij po viheshin nën hetim ligjor në Indi. Roy u arrestua në Indi dhe investimi i paralajmëruar në Maqedoninë e Veriut nuk u realizua.

Në vitin 2022, BIRN [zbuloi](#) se shtetësia i ishte dhënë sportistit ukrainas, Oleksandr Onyshchenko, i cili kishte aplikuar mbi bazën e arritjeve të tij sportive. Problemi ishte se ai ndodhej gjithashtu në listën e zezë të SHBA-së, nën akuzën për ndërhyrje në zgjedhjet amerikane, si dhe ishte objekt i një urdhërarresti ukrainas për korrupsion të dyshuar.

Pas publikimit të raportimit të BIRN, kreu i Agjencisë së Sigurisë Kombëtare dha dorëheqjen nga posti dhe Onyshchenkos iu [hoq](#) shtetësia.

Etiketa: Bashkimi Evropian Maqedonia e Veriut Pasaportat e Arta zona Shengen

Reporter.al

Opinion
Reportazhe
Analiza
Investigime
Lajme
Blog
Rajoni

Rreth nesh
Stafi
Kontakti
Ankesa dhe Korrigjime
Politika e privatesise dhe rregulla te tjera
Letra per redaktorin

Follow Us
X

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara
© 2014 - 2026 Reporter.al - BIRN
Dev by Sllida.PRO